# AUDITIMI SOCIAL NE KOMUNAT E KOSOVËS

## ÇFARË KEMI GJETUR?

Lexoni më poshtë

↓

INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS

# FAKTE NGA AUDITIMI SOCIAL NË GJAKOVË





## ÇFARË MONITORUAM?

**KDI DHE RRJETI QELIZA , NË BASHKËPUNIM ME QYTETARË TË GJAKOVËS, REALIZUAN AUDITIMIN SOCIAL TË ZBATIMIT TË KONTRATËS: "NDËRTIMI I KANALEVE TË UJITJES DHE PENDAVE TË UJIT PËR FERMERËT". VLERA E KONTRATËS: 163,372.00€. GJATË AUDITIMIT NË TEREN U SHQYRTUA POZICIONI "PUNËT MONTUESE"**

SHQYRTIMI I KONTRATËS

VIZITË NË TERREN

DISKUTIM MBI GJETJET



## ÇFARË GJETËM NGA MONITORIMI?

**MUNGESË E FUGAVE TË DILATIMIT** ÇDO 12M TË KANALIT ME BILUMEN ME GJERËSI PREJ 3CM ASHTU SIÇ PARASHIHEJ ME KONTRATË.

**PLASARITJE NË MURIN E KANALIT TË UJITJES** SI PASOJË E MUNGESËS SË PUNIMIT TË FUGAVE TË DILATIMIT.

## ÇFARË REKOMANDUAM PËR KOMUNËN

- **RIPARIMI I MURIT TË ÇARË DHE VENDOSJA E FUGAVE TË DILATIMIT SIPAS SPECIFIKIMEVETEKNIKE.**
- **RRITJA E MBIKËQYRJES GJATË FAZAVE TË NDËRTIMIT PËR TË SHMANGUR MANGËSI TË TILLA.**
- **SIGURIMI DHE PUBLIKIMI I DOKUMENTACIONIT TEKNIK DHE INSPEKTIMEVE.**
- **ZBATIMI I RREPTË I STANDARDEVE NDËRTIMORE NË PROJEKTET E ARDHSHME.**

AUDITIMI SOCIAL NË 12 KOMUNA ËSHTË ZHVILLUAR GJATË PERIUDHËS NËNTOR 2024 – QERSHOR 2025.

INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS

Syri i Vizionit

# FAKTE NGA AUDITIMI SOCIAL NË PEJË



## ÇFARË AUDITUAM?

KDI DHE SYRI I VIZIONIT, NË BASHKËPUNIM ME QYTETARË TË PEJËS, REALIZUAN AUDITIMIN SOCIAL TË ZBATIMIT TË KONTRATËS: "XHEMAJL KADA" (FURRA HUSAJ) DERI TE KANALI ATMOSFERIK FIDANISHTE DHE DULIA,". VLERA E KONTRATËS: 249.240.10€. GJATË AUDITIMIT NË TEREN U SHQYRTUA POZICIONI "NDËRTIMI I KANALIT TË HAPUR ATMOSFERIK NËRRUGEN VRANA KONTIT

SHQYRTIM I KONTRATËS

VIZITË NË TERREN

DISKUTIM MBI GJETJET



## ÇFARË GJETËM NGA AUDITIMI SOCIAL

**FURNIZIMI, TRANSPORTI DHE MURATIMI** I MURIT ME GURË NATYRAL TË GDHENDUR NË FORMË KATËRKËNDËSHI ME DIMENSIONE 30X30X15 CM (PIKA 8.5).

**FURNIZIMI, BLERJA, TRANSPORTI, PUNIMI,** VENDOSJA DHE KOMPAKTIMI I BETONIT TË KLASIT C-25/30 PËR MBULESËN E MURIT ME DIMENSIONE 0,45X0.10M (PIKA 8.6).

**FURNIZIMI DHE MONTIMI I GARDHIT METALIK** ME PROFILE METALIKE 40X80XH600 MM (NENI 8.8).

## ÇFARË REKOMANDUAM PËR KOMUNËN

- TË SHQYRTOHET ZBATIMI I KONTRATËS NGA ANA E KONTRAKTUESIT DHE TË NDËRMERREN MASA PËR TË PËRSHPEJTUAR PËRFUNDIMIN E PUNIMEVE.
- TË BËHET ZBATIMI I PLOTË I SPECIFIKAVE TË KONTRAKTUARA.
- TË SIGUROHET NJË MONITORIM MË I RREPTË I PROGRESIT TË PUNIMEVE DHE PËRMBUSHJES SË KONTRATËS SIPAS KUSHTEVE TEKNIKE.
- NË RAST TË MOSRESPEKTIMIT TË MËTEJSHËM TË KONTRATËS, TË SHQYRTOHET NDËRPRERJA E SAJ DHE MARRJA E MASAVE LIGJORE PËR TË SIGURUAR LLOGARIDHËNIEN.

AUDITIMI SOCIAL NË 12 KOMUNA ËSHTË ZHVILLUAR GJATË PERIUDHËS NËNTOR 2024 - QERSHOR 2025.

INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS

AVONET

# FAKTE NGA AUDITIMI SOCIAL NË FERIZAJ



## ÇFARË MONITORUAM?

NË JANAR 2025, OJQ AVONET BASHKË ME QYTETARË, AKTIVISTË DHE PROFESIONISTË TË FUSHËS KA PËRZGJEDHUR TË MONITOROJË ZBATIMIN E KONTRATËS "PYLLËZIMI DHE RREGULLIMI I PARKUT NË KODRËN E SHERRETËVE", NË VLERË PREJ 917,777.77 EURO DHE ME AFAT TË REALIZIMIT PREJ 3 VITESH. SPECIFIKISHT, ËSHTË MONITORUAR POZICIONI "PUNËT E GJELBËRIMIT".

- SHQYRTIM I KONTRATËS
- VIZITË NË TERREN
- DISKUTIM NGA GJETJET



## ÇFARË GJETËM NGA MONITORIMI?

- **NUMËR I TEPËRT I FIDANËVE:** 4655 FIDANE TË PLANIFIKUARA PËR MBJELLJE POR HAPËSIRA NUK E PËRBALLON.
- **SPECIE PROBLEMATIKE:** PLEPI I BARDHË SHKAKTON ALERGJI - SUGJEROHET HEQJA NGA PLANI I MBJELLJES.
- **MUNGESË E PROJEKTIT DETAJ:** NUK KA NJË PROJEKT ME DETAJET E POZICIONIMIT TË DRUNJVE DHE ELEMENTEVE TJERA.
- **PROBLEME ME CILËSINË E DHEUT:** DHEU EKZISTUES NUK ËSHTË I PËRSHTATSHËM PËR MBJELLJE.
- **MUNGESË PLANI PËR FERTILIZIM:** NUK ËSHTË PARASHIKUAR FERTILIZIMI PËR RRITJEN E BIMËVE.

## ÇFARË REKOMANDUAM PËR KOMUNËN

- RISHIKIM I PLANIT TË MBJELLJES - ZVOGËLIM I NUMRIT TË DRUNJVE.
- PËRJASHTIM I PLEPIT TË BARDHË NGA MBJELLJA.
- PËRFSHIRJA E PLANIT PËR FERTILIZIM.
- PUBLIKIMI I PROJEKTIT DETAL.

INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS

IQS

# FAKTE NGA AUDITIMI SOCIAL NË SKENDERAJ



## ÇFARË AUDITUAM?

KDI, NGO IQS DHE QYTETARË TË SKENDERAJT REALIZUAN AUDITIMIN SOCIAL TË ZBATIMIT TË KONTRATËS:"RREGULLIMI I KASKADAVE TË LUMIT KLINA." VLERA E KONTRATËS: 32,932.65 € | NUMRI I KONTRATËS: 634-23-8207-5-2-1/C430.| PRANIMI TEKNIK ISHTE REALIZUAR NGA KOMUNA. NGJATË AUDITIMIT NË TEREN U SHQYRTUA PIKA 1.3 E KONTRATËS, E CILA PËRFSHIN: GJATËSIA E PARASHIKUAR E MURIT: 65 M DHE LARTËSIA E SPECIFIKUAR E MURIT: 4 M.

SHQYRTIM I KONTRATËS

VIZITË NË TEREN

DISKUTIM MBI GJETJET



## ÇFARË GJETËM NGA AUDITIMI SOCIAL

**TITULLI DHE PËRMBAJTJA E KONTRATËS NUK PËRPUTHEN ME SPECIFIKAT DHE REALITETIN NË TEREN;**

**MOSPËRPUTHJE TË KONTRATËS DHE GJENDJES NË TEREN.** NË KONTRATË LARTËSIA E MURIT ISHTE 4M, POR NË TEREN ISHTE RRETH 2M; GJATËSIA E SPECIFIKUAR ISHTE 65M, NDËRSANË TEREN ËSHTË RRETH 50M;TABELAT JO TË NDARA SIPAS LOKACIONEVE - DOKUMENTACIONI NUK TREGON QARTË SA TABELA JANË VENDOSUR NË CILIN LOKACION, DUKE VËSHTIRËSUAR VERIFIKIMIN;

**GJERËSIA E MURIT NUK ISHTE FARE E SPECIFIKUAR NË KONTRATË, POR NË TEREN U MAT RRETH 25 CM;**

**KOMISIONI KOMUNAL E PRANOI TEKNIKISHT PROJEKTIN,** PAVARËSISHT MOSPËRPUTHJEVE TË TERENIT ME SPECIFIKAT NË KONTRATË TË LARTCEKURA.

## ÇFARË REKOMANDUAM PËR KOMUNËN

- PËRFSHIRJE TË DETAJUAR TË DIMENSIONEVE NË KONTRATË PËR TË SHMANGUR KEQINTERPRETIME NË ZBATIM;
- PËRPUTHJE MES TITULLIT DHE PËRMBAJTJES SË KONTRATËS ME REALITETIN NË TEREN;
- MBIKËQYRJE STRIKTE DHE PRANIME TEKNIKE VETËM PAS PËRPUTHJES ME DOKUMENTACIONIN TEKNIK;
- PËRDORIM I STANDARDEVE TË MATSHME DHE TË QARTA PËR VLERËSIMIN E PUNIMEVE DHESASIVE TË MATERIALEVE.

AUDITIMI SOCIAL NË 12 KOMUNA ËSHTË ZHVILLUAR GJATË PERIUDHËS NËNTOR 2024 - QERSHOR 2025.

INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS

SHL KOSOVA

# FAKTE NGA AUDITIMI SOCIAL NË RAHOVEC



## ÇFARË AUDITUAM?

KDI DHE SHL KOSOVA, NË BASHKËPUNIM ME QYTETARË TË RAHOVEC, REALIZUAN AUDITIMIN SOCIAL TË ZBATIMIT TË KONTRATËS: "GRUMBULLIMI I MBETURINAVE DHE MIRËMBAJTJA E RRUGËVE GJATË DY SEZONAVE". VLERA E KONTRATËS:416,542.80€.

SHQYRTIMI I KONTRATËS

VIZITË NË TERREN

DISKUTIM MBI GJETJET



## ÇFARË GJETËM NGA AUDITIMI SOCIAL

**NË RRUGËN PËR MALISHEVË,** KU MË PARË NDODHEJ DEPONIA ILEGALE MË E MADHE INERTE,ËSHTË VËREJTUR SE AJO ËSHTË ELIMINUAR DHE HAPËSIRA ËSHTË RRETHUAR DHE POMIRËMBAHET NGA KOMUNA.

**DEPONIA ILEGALE NË** FSHATIN HOQË E MADHE NUK ËSHTË ELIMINUAR

## ÇFARË REKOMANDUAM PËR KOMUNËN

- TË RRITET MONITORIMI I KOMPANISË SË PASTRIMIT NGA ANA E ZYRTARËVE PËRGJEGJËS TËKOMUNËS, PËRTË SIGURUAR ZBATIMIN E PLOTË DHE TË BARABARTË TË KONTRATËS NË TË GJITHA LOKACIONET E PËRCAKTUARA.
- TË KETË AKSIONE TË RREGULLTA PASTRIMI TË MBËSHTETURA NGA KOMUNA NË BASHKËPUNIM ME KOMUNITETIN LOKAL DHE ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE.
- DEPONITË ILEGALE TË PASTRUARA TË RRETHOHEN DHE TË SHNDËRROHEN NË PARQE PUBLIKEPËRMES MBJELLJES SË DRUNJVE DHE LULEVE, DUKE PARANDALUAR KRIJIMIN E DEPONIVE TË REJA.
- TË PËRFSHIHET KOMUNITETI NË MËNYRË AKTIVE NË MONITORIMIN E VAZHDUESHËM TË GJENDJES SË LOKACIONEVE TË PASTRUARA, PËRMES MEKANIZMAVE QYTETARË TËMBIKËQYRJES.

AUDITIMI SOCIAL NË 12 KOMUNA ËSHTË ZHVILLUAR GJATË PERIUDHËS NËNTOR 2024 - QERSHOR 2025.

INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS

# FAKTE NGA AUDITIMI SOCIAL NË PRISHTINË



## ÇFARË AUDITUAM?

KDI, NGO QPA DHE QYTETARË TË PRISHTINËS REALIZUAN AUDITIMIN SOCIAL TË KONTRATËS KORNIZË: "FURNIZIMI ME BIÇIKLETA PËR KRYEQYTETIN." VLERA E KONTRATËS: 500,000 € | NUMRI I KONTRATËS: 616-23-4130-1-1-1| PRANIMI TEKNIK ISHTE REALIZUAR NGA KOMUNA.



## ÇFARË GJETËM NGA AUDITIMI SOCIAL

**PIKAT THELBËSORE QË NUK JANË PËRFSHIRË NË KONTRATË, DHE NË PROCES TE PLANIFIKIMIT SI:**

**NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NUMRI I SAKTË I** BIÇIKLETAVE QË DO TË BLIHEN, AS NJË NUMËRI PËRAFËRT;

**NUK ËSHTË PËRMENDUR NUMRI I STACIONEVE** PËR BIÇIKLETAT QË DO TË KRIJOHEN;

**NË BUXHETET E MIRATUARA 2022-2024 NUK ISHTE SPECIFIKUAR NDONJË SHUMË PËR BIÇIKLETA** - VETËM NË RAPORTET BUXHETORE TË PAS-VENDIMIT;

**NUK KA ASNJË EVIDENCË QË TË JETË KRYER NJË** HULUMTIM PARAPRAK I TREGUT PËR TË VLERËSUAR ÇMIMET DHE NEVOJAT;

**SIPAS RAPORTIT TË MENAXHERIT/MBIKËQYRËSIT:** JANË FURNIZUAR 100 BIÇIKLETA DHE JANË NDËRTUAR 10 STACIONE;

**VIZITAT NË TEREN KONFIRMUAN PËRPUTHSHMËRI TË ZBATIMIT ME SPECIFIKAT TEKNIKE.**

## ÇFARË REKOMANDUAM PËR KOMUNËN

- TË SPECIFIKOHET QARTË NUMRI I BIÇIKLETAVE DHE KOSTOJA PËR ÇDO KOMPONENT NË KONTRATË;
- PLANIFIKIMI BUXHETOR TË JETË TRANSPARENT DHE ME KODE TË DEDIKUARA; SIPËRME TË SHTEGUT.
- TË PUBLIKOHEN ARSYET PËR ANULIMIN E THIRRJEVE TË TENDERËVE;
- RAPORTET E MENAXHERIT DHE MBIKËQYRËSIT TË JENË MË ANALITIKE DHE TË DOKUMENTUARA;
- TË PËRFSHIHET KOMPONENTA E MIRËMBAJTJES PËR TË GARANTUAR FUNKSIONALITET AFATGJATË.

AUDITIMI SOCIAL NË 12 KOMUNA ËSHTË ZHVILLUAR GJATË PERIUDHËS NËNTOR 2024 - QERSHOR 2025.

INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS

FORTESA

# FAKTE NGA AUDITIMI SOCIAL NË KAMENICË



## ÇFARË AUDITUAM?

**KDI DHE OJQ FORTESA, NË BASHKËPUNIM ME QYTETARË TË KAMENICËS, REALIZUAN AUDITIMIN SOCIAL TË ZBATIMIT TË KONTRATËS: "NDËRTIMI I PRITOREVE TË AUTOBUSËVE NË HOGOSHT, SHIPASHNICË E POSHTME, KAMENICË, HODONOC, TOPANICË E KORETIN". VLERA E KONTRATËS: 50.000€.**

SHQYRTIMI I KONTRATËS

VIZITË NË TERREN

DISKUTIMI MBI GJETJET



## ÇFARË GJETËM NGA AUDITIMI SOCIAL

**PROJEKTI I NDËRTIMIT TË PRITOREVE TË AUTOBUSËVE** NË KOMUNËN E KAMENICËS QË FILLIMISHT ISHTE PLANIFIKUAR TË PËRFUNDOHEJ BRENDA 45 DITËSH, PO ZGJAT PËR MËSHUMË SE NJË VIT E GJYSMË. KONTRATA E PARË ISHTE NËNSHKRUAR MË 17 NËNTOR 2023 POR ISHTE SHKËPUTUR PËR SHKAK TË ZVARRITJES SË PUNËVE NGA KONTRAKTORI NIKA PRO ING SHPK. **KONTRATA E DYTË (E RITENDERUAR)**, E NËNSHKRUAR MË 26 NËNTOR 2024, PARASHEH PËRFUNDIMIN E PUNIMEVE MË 26 MAJ 2025. PUNËKRYES ËSHTË GRUPI I OPERATORËVE EKONOMIK 3PEZ LLC, KUOTA SH.P.K, VIANTE KONSTRUKSION.

**PËRDERISA NË KONTRATËN E PARË (TË SHKËPUTUR),** NË TITULL ISHIN SPECIFIKUAR 6 LOKACIONE KU DO TË NDËRTOHESHIN PRITORET E AUTOBUSËVE (HOGOSHT, SHIPASHNICË E POSHTME,KAMENICË, HODONOC, TOPANICË E KORETIN) NË KONTRATËN E RITENDERUAR, PËRMENDEN VETËM 2 LOKACIONE, KAMENICË DHE TOPANICË.

**VLERA E KONTRATËS SË PARË PËR NDËRTIMIN E 6 PRITOREVE TË AUTOBUSËVE ISHTE 50.000,00 EUR,** NDËRSA VLERA E KONTRATËS SË RITENDERUAR PËR NDËRTIMIN E VETËM 2 PRITOREVE TË AUTOBUSËVE ËSHTË 47.614.62 EUR.. KOMUNA NUK KA ARSYETUAR PSE ËSHTË PARAPARË BUXHET PËRAFËRSISHT I NJEJTË PËR DY KONTRATA, NDËRKOHË QË VOLUMI I PUNËVE DALLON.

**KONTRATA FILLESTARE (E VITIT 2023) DHE AJO E RITENDERUAR (E VITIT 2024) KARAKTERIZOHEN ME DALLIME TË THEKSUARA NË ÇMIMET E PARASHIKUARA PËR PRODUKTE.** PËR SHEMBULL,ÇMIMI PËR NJË EKRAN VERTIKAL TË JASHTËM NË KONTRATËN FILLESTARE ISHTE PARASHIKUAR 350 EUR, NDËRSA NË KONTRATËN E RITENDERUAR, - EKRANI ME PERFORMANCAT E NJËJTA ËSHTË PARASHIKUAR TË KUSHTOJË 4500 EUR.

**KONTRAKTORI I PARË KISHTE NISUR PUNIMET VETËM NË DY STACIONE.** PËR SHKAK TË ZVARRITJES SË PUNËVE, KOMUNA E KAMENICËS KISHTE DËRGUAR DISA HERË VËREJTJE TE KONTRAKTORI DHE MË 22.07.2024 KISHTE VENDOSUR T'A SHKËPUSË KONTRATËN, PLOT PAS 7 MUAJVE. GJATË MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË KONTRATËS NË TERREN ISHIN VËREJTUR MATERIALE NDËRTIMORE TË LËNA NË VENDE TË PAPËRSHTASHME NË HAPËSIRA PUBLIKE, NDËRSA KABLLOT E ENERGJISË ELEKTRIKE ISHIN LËNË TË PAIZOLUARA. NUK KISHTE TË VENDOSURA AS PARALAJMËRIME APO SINJALIZIME DHE KJO PËRBËNTE RREZIK TË DREJTPËRDREJTË PËR QYTETARËT.

**PUNIMET TË CILAT JANË MARRË PËRSIPËR TË KRYHEN NGA GRUPI I KONTRAKTORËVE (PASRITENDERIMIT)** POASHTU JANË NË FAZËN FILLESTARE. NGA VIZITAT NË TERREN ME 20 MARS, DHE 15 PRILL ËSHTË PARË SE JANË VENDOSUR ÇATITË DHE BAZAT E ULËSEVE NGA BETONIT.SIPAS AFATEVE KOHORE, PUNIMET PARASHIHEN TË PËRFUNDOJNË NË MË PAK SE 3 JAVË, PRA MË 26.05.2025.

## ÇFARË REKOMANDUAM PËR KOMUNËN

- **KOMUNA TË PËRFSHIHET AKTIVISHT NË MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË KONTRATËS NË CDO FAZË TË PROJEKTIT PËR TË SIGURUAR IMPLEMENTIMIN BRENDA AFATEVE TË PARAPARA NË KONTRATË.**
- **KOMUNA TË APLIKOJË MASA NDËSHKIMORE-LIGJORE NDAJ OPERATORËVE TË PAPËRGJEGJSHËM EKONOMIK DHE TË DISKUALIFIKOJË TË NJEJTIT NË PROCEDURA TË TENDERIMIT.**
- **KOMUNA TË BËJË SPECIFIKIM TË QARTË TË PUNËVE NË KONTRATË DHE TË BËJË PËRLLOGARITJE TË SAKTË TË ÇMIMEVE BAZUAR NË KUSHTET E TREGUT.**
- **KOMUNA TË SIGUROJË QË KONTRATAT PUBLIKE TË ZBATOHEN NË ATË MËNYRË QË RESPEKTOJNË SIGURINË PUBLIKE PËR QYTETARËT, VEÇANËRISHT NË ZONAT KU PUNIMET JANË TË PAPËRFUNDUARA.**

**TË ORGANIZOHEN KONSULTIME PUBLIKE PARAPRAKE ME QYTETARË DHE TË PËRFSHIHEN REKOMANDIMET E TYRE NË PROJEKTET KOMUNALE.**

AUDITIMI SOCIAL NË 12 KOMUNA ËSHTË ZHVILLUAR GJATË PERIUDHËS NËNTOR 2024 - QERSHOR 2025.

INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS

# FAKTE NGA AUDITIMI SOCIAL NË KAMENICË



## ÇFARË AUDITUAM?

**KDI DHE OJQ GJETHI, NË BASHKËPUNIM ME QYTETARË TË KAÇANIKUT, REALIZUAN AUDITIMIN SOCIAL TË ZBATIMIT TË KONTRATËS: "NDËRTIMI I SHKALLËVE PËR NGJITJE MBI GURIN E SHPUAR". VLERA E KONTRATËS: 217,999.35€.**



## ÇFARË GJETËM NGA AUDITIMI SOCIAL

**PROJEKTI PËR GËRMIMIN E DHEUT NË THELLËSI 0-300 CM,** QË ISHTE PLANIFIKUAR TË ZGJASË 10 MUAJ (2023-2024), ËSHTË PËRFUNDUAR NË TËRËSI DHE SIPAS PLANIT. JANË HAPUR TË GJITHA RASE DHE ËSHTË MUNDËSUAR QASJA NË RRUGË PËR GJATËSI 900M SHTESË. CILËSIA ËSHTË VLERËSUAR SI MESATARE.

**MURET PARALELE NGA GURI I PËRPUNUAR, ME GJATËSI TË PARAPARË PREJ 453M,** JANË NDËRTUAR VETËM 320M APO 71%. KA PASUR VONESA PREJ 9% DHE PROJEKTI NUK ËSHTË NË PËRPUTHJE TË PLOTË ME PLANIN DINAMIK.

**PËR STRUKTURËN E SHKALLËVE NGA GURI DHE PUSHIMOREVE, JANË REALIZUAR VETËM 59% TË PUNIMEVE,** ME VONESA TË THEKSUARA PREJ 21%. SHKALLËT DHE PUSHIMORET ISHIN PLANIFIKUAR PËR 15 MUAJ PUNË, POR NUK ËSHTË ARRITUR PROGRESI I PRITUR PËR VITIN 2025.

**PLATFORMA REKREATIVE TE FILLIMI I SHKALLËVE NUK ËSHTË REALIZUAR FARE.** EKIPI MBIKËQYRËS KA VENDOSUR TË MOS E ZBATOJË KËTË PJESË TË PROJEKTIT DHE KA BARTUR SASINË E MATERIALIT PËR AKTIVITETE TJERA MË TË NEVOJSHME.

**PUNIMET NË MVESHJEN E MUREVE ME BETONARME** JANË NË PËRFUNDIM, ME 97% TË VOLUMIT TË PUNUAR. PJESËT QË MBESIN JANË SHUMË TË VOGLA DHE KRYESISHT LIDHEN ME MBULIMIN ME GURË DEKORATIV DHE INSTALIMIN E RRETHOJAVE METALIKE.

**NDËRTIMI I STRUKTURËS SË BETONARMEVE NË MURE** DHE SERKLAZHE ËSHTË REALIZUAR NË 85% TË PLANIT. EDHE PSE KA VONESA PREJ 15%, CILËSIA ËSHTË VLERËSUAR SI SHUMË E MIRË DHE PJESA MË E MADHE E BETONIMIT ËSHTË REALIZUAR NË PËRPUTHJE ME PLANIN.

**PUNIMET PËR ULËSET PREJ ÇELIKU DHE DRURI (9 COPË) DHE SHPORTAT E MBETURINAVE (8COPË)** NUK KANË FILLUAR ENDE. JANË PLANIFIKUAR PËR T'U REALIZUAR NË MUAJT SHKURT, MARS DHE PRILL 2025. ZVARRITJA PARAQET RREZIK QË TË MOS ARRIHEN AFATET E PARASHIKUARA.

**GARDHI METALIK MBI MURET ANËSORE ËSHTË REALIZUAR NË 70%** TË GJATËSI SË PLANIFIKUAR (400M NGA 565M). NË KËTË KOMPONENT ËSHTË TEJKALUAR PLANI PËR 20%, POR CILËSIA ËSHTË VLERËSUAR SI MESATARE.

**GYPAT ELEKTRIKË PËRGJATË TRASEVE PËR NDRIÇIM NUK KANË FILLUAR TË IMPLEMENTOHEN,** MEGJITHËSE JANË VETËM TRE MUAJ TË MBETUR DERI NË AFATIN PËRFUNDIMTAR (PRILL 2025). KY KOMPONENT ËSHTË VONUAR NDJESHËM

**AKTIVITETI PËR MBJELLJEN E 9 DRUNJVE DEKORATIVË** (DRU BLIRI OSE PLATANOIDE) NUK KA FILLUAR ENDE. SIPAS PLANIT, KY AKTIVITET DUHET TË REALIZOHET DERI NË FUND TË MARSIT 2025.

## ÇFARË REKOMANDUAM PËR KOMUNËN

- **TË PËRMIRËSOHET CILËSIA E PUNIMEVE, SIDOMOS NË GËRMIM/NGJESHJE DHE PUNIMET ME GURË E RRETHOJAT METALIKE.**
- **TË NDËRTOHEN OSE PËRFORCOHEN STRUKTURA MBROJTËSE NË ZONAT KU TERRENI ËSHTË MË I LARTË SE MURET, PËR TË SHMANGUR RRËSHQITJEN E DHEUT. SIPAS NEVOJËS, TË SHKURTËZOHET TRASEJA DHE TË RIALOKOHEN MJETET.**
- **TË RIPAROHEN DËMTIMET NË STRUKTURAT E GURIT NË PJESËN E SIPËRME TË SHTEGUT.**
- **TË RIVLERËSOHEN PUNËT E MBETURA NË RAPORT ME KOHËN DHE TË SIGUROHET PËRFUNDIMI ME CILËSI MË TË LARTË.**
- **TË PROJEKTOHEN ZGJIDHJE PËR MENAXHIMIN E UJËRAVE ATMOSFERIKË, SI BRENDA ASHTU EDHE JASHTË TRASEVE, PËR TË PARANDALUAR DËMTIME NË TË ARDHMEN.**
- **TË PLANIFIKOHEN PROJEKTE VAZHDUESE SI ZGJERIMI I SHTEGUT, LIDHJE PËR KËMBËSORË DHE RREGULLIMI I ZONËS REKREATIVE TE GURI I SHPUAR.**
- **TË ZHVILLOHET NJË PROCES I HAPUR KONSULTIMI ME KOMUNËN, PROJEKTUESIT DHE KOMUNITETIN PËR TË PËRMIRËSUAR PROJEKTET PUBLIKE NË TË ARDHMEN.**

AUDITIMI SOCIAL NË 12 KOMUNA ËSHTË ZHVILLUAR GJATË PERIUDHËS NËNTOR 2024 – QERSHOR 2025.

INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS

Public Organization for Local Initiatives and Supports POLIS

# FAKTE NGA AUDITIMI SOCIAL NË LIPJAN



## ÇFARË AUDITUAM?

KDI, NGO POLIS DHE QYTETARË TË LIPJANIT REALIZUAN AUDITIMIN SOCIAL TË KONTRATËS: "NDËRTIMI I PARQEVE DHE LOJRAVE PËR FËMIJË NË SHKOLLA FILLORE NË FSHATRAT: KRAISHTË, GLLOGOVC, RUBOVC, BUJAN, MEDVEC, TOPLIQAN, KROJMIR, BAICË, SHALË, MAGURE,PUTUROVC, SMALLUSHË, LLUGAXHI, BABUSH I MUHAXHERËVE, BANULLË, DOBRAJË E MADHE, LIPJAN - FAZA E DYTË - RITENDERIM." VLERA E KONTRATËS: 184,488 € | NUMRI I KONTRATËS: 613-022-052-521 | PRANIMI TEKNIK ISHTE REALIZUAR NGA KOMUNA.

SHQYRTIM I KONTRATËS

VIZITË NË TERREN

DISKUTIM MBI GJETJET



## ÇFARË GJETËM NGA AUDITIMI SOCIAL

**SI LOKACIONE MOSTËR PËR INSPEKTIM NË TEREN JANË PËRZGJEDHUR FSHATRAT RUBOFC DHE LLUGAXHI. NGA AUDITIMI SOCIAL U VËREJT:**

**PUNIMET NË KËNDET E LOJËRAVE ISHIN PËRGJITHËSISHT** NË PËRPUTHJE ME SPECIFIKIMET TEKNIKE TË PËRCAKTUARA NË KONTRATË;

**VLERA E KONTRATËS ISHTE NË PËRPUTHJE ME** PLANIFIKIMET BUXHETORE PËR VITET 2022 DHE 2023.

## ÇFARË REKOMANDUAM PËR KOMUNËN

- TË ORGANIZOJË KONSULTIME ME KOMUNITETIN NË PROJEKTE TË NGJASHMEPARAPRAKISHT;
- TË SIGUROJË MIRËMBAJTJE TË RREGULLT TË KËNDEVE TË LOJËRAVE;
- TË PËRDORË MATERIALE EKOLOGJIKE PËR NDËRTIM DHE PAJISJ;
- TË VENDOSË TABELA INFORMUESE PËR PËRDORIM TË SIGURT DHE UDHËZIME PËR MOSHAT E REKOMANDUARA
- PËRDORIM I STANDARDEVE TË MATSHME DHE TË QARTA PËR VLERËSIMIN E PUNIMEVE DHESASIVE TË MATERIALEVE.

AUDITIMI SOCIAL NË 12 KOMUNA ËSHTË ZHVILLUAR GJATË PERIUDHËS NËNTOR 2024 - QERSHOR 2025.

INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS

Mundësia

# FAKTE NGA AUDITIMI SOCIAL NË MITROVICË



## ÇFARË AUDITUAM?

KDI DHE OJQ MUNDËSIA, NË BASHKËPUNIM ME QYTETARË TË MITROVICËS, REALIZUAN AUDITIMIN SOCIAL TË ZBATIMIT TË KONTRATËS: "FURNIZIMI ME TABELA VETËDIJESUESE, ÇANTA EKOLOGJIKE DHE SHËRBIMI I DIZAJNIT DHE PRINTIMIT TË MATERIALEVE VETËDIJESUESE PËRMJEDIS."VLERA E KONTRATËS: 17,888.75 € | NUMRI I PROKURIMIT: 642-24-785.GJATË AUDITIMIT NË TEREN U SHQYRTUA KËTO PIKA TË KONTRATËS: VENDOSJA E SHPORTAVE PËR MBETURINA | VENDOSJA E TABELAVE VETËDIJESUESE | SHPËRNDARJA E ÇANTAVE EKOLOGJIKE;

SHQYRTIMI I KONTRATËS

VIZITË NË TERREN

DISKUTIM MBI GJETJET



## ÇFARË GJETËM NGA AUDITIMI SOCIAL

**MUNGESË E INFORMACIONIT TË QARTË MBI SHPËRNDARJEN E ÇANTAVE.** NUK U OFRUA ASNJË DËSHMI PËR SHPËRNDARJEN E ÇANTAVE ME VLERË RRETH 10,000 €, NDONËSE PROJEKTI ISHTE RAPORTUAR SI I PËRFUNDUAR;

**SHPORTA TË PA INSTALUARA -** 46 SHPORTA TË PLANIFIKUARA NË LAGJEN FRASHËR NUK ISHIN VENDOSUR ENDE, EDHE PSE PROJEKTI FIGURONTE SI I PËRFUNDUAR;

**TABELAT JO TË NDARA SIPAS LOKACIONEVE -** DOKUMENTACIONI NUK TREGON QARTË SA TABELA JANË VENDOSUR NË CILIN LOKACION, DUKE VËSHTIRËSUAR VERIFIKIMIN;

**MUNGON ANALIZA E NDIKIMIT -** NUK ËSHTË VLERËSUAR EFEKTI I SHPËRNDARJES SËÇANTAVE APO VENDOSJES SË TABELAVE NË VETËDIJESIMIN MJEDISOR.

## ÇFARË REKOMANDUAM PËR KOMUNËN

- SPECIFIKIM I QARTË I LOKACIONEVE PËR VENDOSJEN E MATERIALEVE NË PROJEKTET PUBLIKE;
- DOKUMENTIM DHE RAPORTIM PUBLIK TË AKTIVITETEVE DHE SHPËRNDARJEVE ME DËSHMI KONKRETE;
- CAKTIMI I AFATEVE TË QARTA KOHORE PËR ÇDO AKTIVITET TË PROJEKTIT;
- REKOMANDOHET QË NË VENDOSJEN E TABELAVE VETËDIJESUESE DHE PRODUKTEVE TË TJERA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË PËRDOREN MATERIALE TË QËNDRUESHME DHE EKOLOGJIKE.

AUDITIMI SOCIAL NË 12 KOMUNA ËSHTË ZHVILLUAR GJATË PERIUDHËS NËNTOR 2024 - QERSHOR 2025.

INSTITUTI
DEMOKRATIK
I KOSOVËS

# FAKTE NGA AUDITIMI SOCIAL NË PODUJEVË

## ÇFARË AUDITUAM?

KDI, OJQ EKOVIZIONI DHE QYTETARË TË PODUJEVËS REALIZUAN AUDITIMIN SOCIAL TË KONTRATËS: "RIKONSTRUKTIMI I RRUGËS 'SKËNDERBEU' ME INFRASTRUKTURË PËRCJELLËSE." VLERA E KONTRATËS: 1,316,502.96 € | NUMRI I KONTRATËS : 615-22-833-5-1-1/C680. GJATË AUDITIMIT NË TEREN U SHQYRTU PIKA E KONTRATËS PWR KRIJIMIN E SHTIGJEVE TË BICIKLETAVE,

SHQYRTIM I KONTRATËS

VIZITË NË TERREN

DISKUTIM MBI GJETJET





## ÇFARË GJETËM NGA AUDITIMI SOCIAL

**PUNIMET ISHIN PËRGJITHËSISHT NË PËRPUTHJE ME SPECIFIKIMET TEKNIKE TË PËRCAKTUARA NË KONTRATË;** NGA 7 SPECIFIKA TË KONTRATËS TË SHQYRTUARA, 5 JANË ZBATUAR, NDËRSA 2 NUK JANË REALIZUAR, PËRFSHIRË:

- SHENJËZIMIN TERMOPLASTIK ME FIGURËN E BIÇIKLETËS
- VIZATIMI I VIJAVE KUFIZUESE ME CILËSI TË LARTË REFLEKTIMI

**NË TEREN U VËREJT MUNGESË E SHENJAVË TË MJAFTUESHME PËR SHTEGUN E BIÇIKLETAVE.**

## ÇFARË REKOMANDUAM PËR KOMUNËN

- TË KOMPLETOHET SHENJËZIMI HORIZONTAL SIPAS SPECIFIKIMEVE TË KONTRATËS, PËRFSHIRË FIGURINËN E BIÇIKLETËS DHE SHIGJETAT UDHËZUESE ÇDO 150 M.
- TË GARANTOHET MONITORIM TEKNIK I RREGULLT PËR ZBATIMIN KORREKT TË STANDARDEVE TË NDRIÇIMIT, SINJALISTIKËS DHE SHTIGJEVE TË BIÇIKLETAVE.
- TË PUBLIKOHEN TË DHËNAT MBI AFATIN E REALIZIMIT DHE PRANIMIN E PUNIMEVE, PËR TË SHMANGUR MUNGESËN E LLOGARIDHËNIES.
- TË FORCOHEN MEKANIZMAT E MBIKËQYRJES KOMUNALE PËR ZBATIMIN CILËSOR TË KONTRATAVE PUBLIKE.

AUDITIMI SOCIAL NË 12 KOMUNA ËSHTË ZHVILLUAR GJATË PERIUDHËS NËNTOR 2024 - QERSHOR 2025.